



#ForumEuropaeum

THIRRJE

Tregim mbi aderimin e Maqedonisë në BE 2.0

Rivlersimi i pritjeve, mundësive dhe realiteteve

Instituti për politikë evropiane (EPI) - Shkup me kënaqësi Ju fton në konferencën "Tregim mbi aderimin e Maqedonisë në BE 2.0", që do të mbahet më 29 shtator, 2017 (e premte), në hotelin "Holiday Inn" Shkup, me fillim në ora 12:30.

Ju lutemi konfirmoni ardhjen tuaj në 02/3280 100 ose në contact@epi.org.mk deri në datën 27 shtator (e mërkurë).

12:30 – 13:00

Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe deklarata për mediumet

13:00 – 13:15

Fjala hyrëse

-Dr. Simonida Kacarska, Drejtoreshë, EPI

Sesioni i parë:

13:15 – 14:45

"Maqedonia dhe bashkimi Evropian – shansi i dytë"

- Radmilla Sheqerinska, Zëvendës kryeministre e Qeverisë së RM-së dhe Ministre e mbrojtjes
- Dr. Antoaneta Dimitrova, Profesoreshë inordinare në Universitetin e Lajdenit
- Nikolla Popovski, Deputet dhe ish Ministër i punëve të jashtme
- Dr. Adam Fagan, Profesor, udhëheqës fakulteti, Univerziteti Queen Mary
- Dr. Malinka Ristevska Jordanova, EPI

Moderatore: Dr. Ardita Abazi Imeri, EPI

14:45 – 15:00

Pauzë për kafe

Sesioni i dytë:

15:00 – 16:15

"Qeveria e re – inxhinieri e re për fqinjësi të mirë – sa e qëndrueshme?"

- Dr. Fatmir Besimi, Ish zëvendës kryeministër i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane
- Julijana Nikollova, Qendra për modernizim të politikave, Sofje
- Tobias Flessenkemper, Bashkëpunues i lartë shkencor dhe Drejtor i departamentit
- Dimitar Bellçev, Ish diplomat
- Sasho Klekovski, Konsultant i pavarur

Moderator: Aleksandar Jovanoski, EPI

16:15 – 16:30

Përfundime: Arbenita Ismani Sakipi, Kryetare e Kuvendit të EPI

16:30 – 17:00

Koktel

Përkthim simultan: maqedonisht, shqip dhe anglisht



THINK FUND
SUPPORTING POLICY RESEARCH

Qëllimi

Qëllimi i kësaj tryeze të rumbullakët është të inkurajojë debatë të hapur dhe konstruktive në mes aktorëve qeveritar dhe jo-qeveritar në vrrullin aktual Maqedonas. Qeveria e re është angazhuar të rishikojë rrugën drejt integritimeve në BE dhe të avancojë marrëdhëniet me fqinjët duke përdorur si mjet bashkëpunimin bilateral. Sidoqoftë, qeveria ballafaqohet me detyrën e brishtë të gjejë barazpeshë adekuate në mes dëshirës për t'iu pëmbajtur standardeve të UE-së dhe kontekstit të ndjeshëm rajonal; dhe nevojës të miratojë reforma dhe strategji relevante kontekstuale. Duke pasur këtë parasysh, debati do të përqëndrohet në mjetet që janë në dispozicion për të hartuar trajektore të re për zgjidhje të qëndrueshme në mënyrë që të korrighohen problemet thellësisht të rrënjosura.

Prapavija

Vitin e kaluar gjatë konferencës tonë vjetore, ne folëm për krizën politike të asaj kohe. Kjo situatë politike përfundimisht u reflektua në raportin e Komisionit Evropian që definoi Maqedoninë si shtet i pushtuar. Përveç përkeqësimit të situatës politike, bashkëpunimi bilateral dhe dialogu me Greqinë u bllokua tërësisht. Përveç kësaj, marrëdhëniet me Bullgarinë gjithashtu morrën kthesë të gabuar.

Më 11 dhjetor të vitit 2016, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Rezultatet e ngushta shpion deri tek formimi i koalicionit qeveritar, i kundërshtuar nga ish partia që ishte në pushtet që arriti kulmin me sulmet në Kuvend më 27 prill. Komuniteti ndërkombëtar unanimisht dënoi sulmet, duke i emëruar ato si sulme të organizuara dhe kollaps total i demokracisë.

Qeveria e re përfundimisht u formua më 1 qershor. Edhe pse ende në ditët fillestare të egzistimit, është angazhuar t'i lirojë institucionet, rifitojë besimin e qytetarëve dhe të sjellë shtetin përsëri në rrugëtimin e saj Euro-Atlantik. Për më tepër, Ministrat e qeverisë së re janë angazhuar në nxitjen e bisedimeve bilaterale miqësore me fqinjët tanë. Në fillim të gushtit, kryeministrat e Maqedonisë dhe Bullgarisë nënshkruan marrëveshjen për marrëdhënie të mira fqinjësore të ndjekura me diskutime dhe spekulime të mëdha. Në të njëjtën kohë, kryeministri Zaev përdori vizitën e tij të parë në Bruksel të trajtojë çështjen me Greqinë dhe të njohtojë se “nëse ne kemi marrëdhënie miqësore dhe qasje të mirë atëherë është e mundshme gjetja e zgjidhjes”. Zëvendës kryeministrja dhe Ministre e mbrojtjes Shekerinska dhe Ministri i punëve të jashtme Dimitrov gjithashtu rihapën çështjen e NATO-s, duke shtyrë Republikën e Maqedonisë të hyjë në Aleancë nën referencën të përkohshme. Përveç kësaj, zëvendës kryeministri për Çështje Evropiane Osmani definoi dy trajektore – një për marrëdhëniet bilaterale me fqinjët, dhe tjetra si synim për të arritur konsensus nacional për reformat e BE-së në vend.

Duke e pasur parasysh të gjithë këtë, ne kemi momentin për fillim të ri. Megjithatë, vrulli duhet të përdoret me mençuri, sepse “gabimet e të kaluarës nuk duhet përsëritur dhe se një formë e shtetit të kapluar nuk duhet zëvendësuar me formë tjetër”. Reformat duhet të planifikohen në mënyrë që të jenë vërtetë të qëndrueshme. Bashkimi Evropian, si nëpërmjet veprimeve të shteteve kryesore anëtare ashtu edhe nëpërmjet institucioneve kryesore, ka mbështetur përpjekjet dhe veprimet për kthimin e vendit në trajektoren e aderimit në BE. Megjithatë, mbetet pyetja nëse ekziston ende vullneti dhe interesi i mjaftueshëm i BE-së që të ndihmojë Maqedoninë në mënyrë strategjike. Partneritetet strategjike si ato të diskutuara kohët e fundit me kandidatët e tjerë të rajonit mund të jenë një rrugë përpara në këtë drejtim.

1 | 2017 Report of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues in the former Yugoslav Republic of Macedonia, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf